



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L -247

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-061 PËR
SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA
BANESORE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-061
PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA
BANESORE**

Neni 1

Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3 togfjalëshi “**dy (2) vitesh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji**”, zëvendësohet me togfjalëshin “**tri (3) vitesh, nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit bazik**”.

Neni 2

Neni 32 i ligjit bazik, togfjalëshi “**deri në dy (2) vite, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji**” zëvendësohet me togfjalëshin “**deri në tri (3) vite, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit bazik.**”

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L -247
27 mars 2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI